

Lista falas dhe e lirë për përdorimin e veglave digjitale për mbështetje të mësimit nga distanca gjatë mbylljes së përkohshme të shkollave



Me mbylljen e përkohshme të shkollave, mësimi digjital nga distanca, kur është i mundshëm teknologjikisht, mund t'i ndihmojë fëmijët ta vazhdojnë mësimin në shtëpi. Ekspertët e arsimit kanë siguruar këtë listë falas dhe të lirë për përdorim të platformave digjitale, aplikacioneve dhe përmbajtjeve, të cilat mund të jenë të dobishme.

Lista nuk ka për qëllim ta zëvendësojë materialin shkollor të përgatitur nga shkollat dhe mësuesit. Ajo paraqet një listë të burimeve mësimore joformale jashtë programit mësimor. Shumica e tyre janë falas, edhe pse ndoshta për disa sosh, prindërit do të duhet të paguajnë për përmbajtjet ose veçoritë shtesë.

Përfshirja e platformave në këtë listë nuk do të thotë që UNICEF-i është autori i tyre, ndonëse ato janë vegla digjitale të pranuar dhe të përdorura gjerësisht. Ne bëjmë çmos për t'i gjetur dhe përfshirë burimet në gjuhët lokale, edhe pse shumica e burimeve të dhëna këtu janë në gjuhën angleze dhe në gjuhë tjera.

Listën do ta azhurnojmë rregullisht, andaj nëse keni sugjerime për plotësime **ju lusim na jepni propozime!**

Përkujdesuni që mësimi i fëmijës suaj në rrjetet të internetit të jetë zbavitës dhe i sigurtë

Kur bëhet fjalë për mësim të fëmijëve në rrjetin e internetit, prindërit dhe tutorët duhet gjithnjë ta mbajnë mend:

- Pjesëmarrjen aktive në mësimin e fëmijëve të tyre. Ta përdorin teknologjinë si një komponent e procesit mësimor në të cilin ka bashkëveprim me njerëzit tjerë, duke e ditur që vetë teknologjia si e tillë nuk mund ta zëvendësojë praninë dhe udhëzimin e mësuesve ose prindërve. Kjo veçanërisht vlen për fëmijët më të vegjël.

- Mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve. Prindërit dhe kujdestarët duhet t'i kontrollojnë burimet digjitale të përdorura nga fëmijët, gjegjësisht t'i shmangin ato që nuk duken të sigurtë ose ato për të cilat kërkohen informacione të hollësishme personale. Identiteti i fëmijës, vendndodhja e tyre, përkatësia kombëtare ose fetare nuk duhet të jenë pjesë e informacioneve të kërkuara për të hyrë në burimet mësimore.

Njësitë digjitale mësimore:

UNICEF "Shoqëria MELA": libra digjitale me ilustrime në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe për fëmijët e moshës parashkollore dhe fëmijët më të vegjël, të cilët e ndjekin arsimin fillor. Te gjitha librat mund të shkarkohen nga këtu <https://issuu.com/unicefmk>

Hap pas hapi: Libra digjitale me ilustrime në gjuhën e shenjave si dhe aktivitete për mësim digjital dhe libra ilustrimesh me tregime në gjuhën maqedonase, shqipe, turke dhe boshnjake për fëmijët e moshës parashkollore dhe ata të arsimit të hershëm fillor <https://stepbystep.org.mk/en/biblioteka>

Global Digital Library (Biblioteka Globale Botërore): e promovon shkrim leximin në klasat e ulëta duke mundësuar qasje në libra digjitale, tregime për fëmijëve dhe fragmente tjera në gjuhë të shumta. Për këtë angazhim mund të përdoret kompjuteri. Më shumë informacion gjenden në: <https://www.digitallibrary.io/>

StoryWeaver (Narratori): Baza digjitale në shumë gjuhë me tregime për fëmijë. Mund të përdoret përmes celularit ose kompjuterit. Më shumë informacione gjenden në: <https://storyweaver.org.in/>

Worldreader (Lexues botëror): Siguron qasje falas në një bibliotekë të madhe të librave digjitale dhe tregimeve që mund të qasen përmes një pajisje celulare dhe kompjuterit. Qasja mundësohet përmes Google Play Store. Më shumë informacion gjenden në: <https://www.read.worldreader.org/>

Aplikacionet mësimore:

- Mësimi i gjuhëve:

Akelius. Aplikacion për të mësuar gjuhë dhe platformë në internet e përqendruar te fëmijët që nuk e flasin ende gjuhën e tyre amtare dhe kanë nevojë të mësojnë një gjuhë të huaj. Mund të përdoret në pajisjet celulare, kompjuterët dhe përmes Google Play. Gjuhët e disponueshme janë: greqishtja, anglishtja, frëngjishtja, suedishtja. Mund të keni qasje përmes: <https://www.akelius.com/en/language-course> ose aplikacionit të zbritet nga Google Play.

Duolingo. Aplikacion për mësim të gjuhëve, e cila mund të përdoret përmes pajisjes celulare ose përmes kompjuterit. Gjendet përmes Google Play, App Store. Më shumë informacione gjenden në: <https://www.duolingo.com/>

- Bazat e shkrim leximit dhe matematikës:

Age of Learning (Moshë e mësimi) (tre produkte: ABC Mouse, Reading IQ, Adventure Academy). Produkte të cilat e inkurajojnë mësimin e shkrim leximit dhe matematikës në një moshë të re; Adventure Academy si target grup i ka fëmijët pak më të rritur. Si masë ndaj rastit të COVID-19, kjo kompani i ka dhënë UNICEF-it një kod për shkarkim falas të produkteve për t'u përdorur për shkak të mbylljes së shkollave. Përmbajtjet janë në dispozicion në gjuhën angleze dhe (pjesërisht) në gjuhën spanjishte.

Nëse e shënonin kodin AOFLUNICEF në këto lidhje të internetit, mund të keni qasje në secilin aplikacion ndaras. Lirisht ndajeni me bashkësinë tuaj.

www.ABCmouse.com/redeem

www.AdventureAcademy.com/redeem

www.ReadingIQ.com/redeem

Përshkrim më i detajuar i secilit aplikacion në kuadër të Age of Learning:

- **ABCmouse (ABC miu)** ABCmouse Early Learning Academy's i përfshin të gjitha fushat kryesore arsimore, duke përfshirë leximin dhe gjuhën, matematikën, shkencat natyrore, shëndetësinë, shkencat shoqërore, artet dhe muzikën. ABCmouse është krijuar për ta stimuluar mësimin e fëmijëve dhe përfshin mbi 11,000 aktivitete mësimore, me secilin aktivitet të dizajnuar individualisht për të tërhequr fëmijë, si dhe për t'i ndihmuar ata t'i përmbushin qëllimet e tyre themelore të të mësuarit. ABCmouse përfshin qasje në programe të përshtatshme dhe të mbështetura në lojë **Mastering Math (Përvetësimi i matematikës)** dhe **Mastering Reading (Përvetësimi i leximit)**

- **Adventure Academy (Akademia Avanturiste)** Adventure Academy është një lojë masive interneti me karakter edukativ për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme. Ajo përmban mijëra aktivitete mësimore

interesante, të cilat zbulohen gjatë kërkimit në botën virtuale interaktive. Është projektuar në mënyrë profesionale për të siguruar mjedis arsimor shumë interaktiv. Aplikacioni Adventure Academy përqendrohet në zhvillimin e njohurive dhe aftësive kritike në gjuhë, matematikë, shkenca sociale, shkenca natyrore etj.

- **ReadingIQ (Inteligjenca e leximit)** ReadingIQ është program i hartuar nga ekspertë për ta përmirësuar arsimimin dhe për t'i përafuar fëmijët deri në moshën 12 vjeç me libra të përshtatshëm për klasën e tyre dhe aftësinë e tyre të leximit. Nga librat me ilustrime të bukura, serialet popullore dhe stripat, deri tek tregimet e ilustruara për fëmijë, romanet vizatimore dhe librat me tema të ndryshme, ReadingIQ është një bibliotekë personale mësimore, që iu ndihmon fëmijët të zhvillohen si lexues.

- Shkathtësi për programim

Ka shumë burime falas në internet për fëmijë dhe të rinj përmes të cilave ata mund ta mësojnë TIK-në dhe programimin. Ato janë në dispozicion për një larmi moshash (madje edhe atë parashkollore), si dhe për të mësuar gjuhë të ndryshme programimi. Ju mund të gjeni një listë të burimeve të disponueshme në faqen e internetit të IT Girls (IT vajza), ku mund të gjeni listë me resurse të disponueshme: <http://itgirls.ba/postani-it-girl/>

Platforma mësimore me përmbajtje të ndryshme

(në veçanti të dobishme për më të rriturit, nxënësit e motivuar, ose për mësim me përfshirje aktive të prindërve/kujdestarëve)

Alison. Internet kurse falas për lëndë të ndryshme. Mund të keni qasje përmes kompjuterit. Është në dispozicion në këto gjuhë: anglisht, spanjisht, frëngjisht, italisht dhe portugalisht. Gjetet në: <https://alison.com/>

Coursera. Kurse në internet të ligjëruara nga mësues të universitete të mirënjohura dhe nga kompani të njohura. Mund të keni qasje përmes pajisjeve celulare dhe kompjuterit. Shumica e kurseve janë në gjuhën angleze. <https://www.coursera.org/>

EdX. Kurse falas në internet nga institucionet arsimore në të gjithë botën. Të disponueshme në pajisjet celulare dhe kompjuter përmes Apple store, Google Play. Shumica e kurseve janë në anglisht. <https://www.edx.org/>

EkStep. Platformë e hapur e të mësuarit me një koleksion të burimeve të shkrim leximit dhe matematikës. Qasja mundësohet përmes pajisjeve celulare dhe kompjuterëve. Në dispozicion në Google Play. Kryesisht në anglisht. Nxënësit krijojnë qase në përmbajtje interaktive. Më shumë informacion gjenden në: <https://ekstep.in/>

Khan Academy. Kurse, ligjërata dhe mësim falas në internet. Qasja mundësohet përmes pajisjeve celulare dhe kompjuterëve. Në dispozicion në Google Play, App Store, Amazon App Store. Gjetet në më shumë gjuhë. Më shumë informacion gjenden në: <https://www.khanacademy.org/>

Kolibri. Platformë digjitale me burim të hapur për komunitetet me burime të kufizuara, e cila funksionon edhe pa qasje në internet. Qasja mundësohet përmes kompjuterit. Gjetet në më shumë gjuhë. Më shumë informacion gjenden në: <https://learningequality.org/kolibri/>

Agjencia jonë simotra UNESCO rekomandon të përdorni një shumëllojshmëri të aplikacioneve arsimore të hapura dhe të platformave, të cilat e lehtësojnë mësimin dhe mundësojnë ndërveprim dhe kujdes shoqëror, të cilat janë në dispozicion në gjuhë të shumta. Këtu mund ta gjeni listën e plotë: <https://en.unesco.org/themes/education-emergencies/coronavirus-school-closures/solutions>